

SHOQËRIA TREGTARE ME ORTAKËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

X – ALBANIA SH.P.K

AKT THEMELIMIT

Në Durrës, sot me datë 01.11.2024,(dymijë e njëzetë e katër) ditë e Premte, shtetasi me këtë identitet:

Z. Almarin Kulla, atësia **Bashkim** dhe mëmësia **Meleke**, i datëlindjes 18.12.1990, shtetas shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, identiteti i të cilit verifikohet me kartë identiteti numër 035229189 numër personal J01218066N me afat deri 04.12.2029

krijoi:

Shoqërinë Tregtare me ortakëri dhe me përgjegjësi të kufizuar

X - ALBANIA SH.P.K

- Vullnetin e tij të të lirë, të plotë, të sinqertë, dhe në inisiativën e lirë private
- Në Kushtetunën e Republikës së Shqipërisë dhe kodin Civil në fuqi.
- Në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregare”
- Në ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën kombëtare të Rregjistrimit”
- Në ligjin Nr.7764 datë 02.11.1993 “Për Investimet e huaja”

dhe në të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe Konvetat ndërkombëtare të gjithëpranuara të **Komunitetit Europian**, me anën e këtij **Akti Themelimi**, krijojmë **Shoqërinë Tregtare me Ortakëri** dhe përgjegjësi të kufizuar

X – ALBANIA SH.P.K

NENI 1

Krijohet Shoqëria tregtare me emrin **X – Albania SH.P.K** emërtim do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

NENI 2

Selia Qëndrore e Shoqërisë është në adresën: Durrës, Lagjia 6 Rruga Aleksander Goga Muzeumi Dëshmorëve, Autoveture Tip Hyundai Ioniq me targe AB 105 HP

NENI 3

Shoqëria shtrin aktivitetin në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së ortakëve mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe përfaqësi si në qytete dhe jashtë shtetit. Njësitë e tjera strukturore të Shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqërisë është në likuiditet në shumë 100,000 Lekë (njëqindmijë lek), i ndarë në 1 kuotë të formuara dhe nënshkruar nga ortaku i vetëm sipas këtij kontributi:

1. **Ortaku Z. Almarin Kulla**, kontribues me shumën 100,000 Lekë e barabartë me 1 kuotë me të drejtë vendimore e barabartë me 100%.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjetër (të luajtshme apo të paluajtshme), të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Ortaku ka të drejtëtë transferojnë jashtë territorit të republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e tyre ,përfshirë fondet dhe vlerat e kontributit në natyrë bazuar në të drejtën që u njeh Ligji **“Për Investimet e Huaja”**

Shoqëria dhe të tretët, respektojnë këto transferime sapa tu bëhen të ditura.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë.



NENI 6

Kohëzgjatja e Ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 7

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim qendrës kompetente për të bërë shënimet e nevojshme në regjistrin e shoqërive tregtare.

NENI 8

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e Kontratës së themelit dhe këtij Statuti të saj.

NENI 9

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këtë drejtim:

Transport Udhëtarësh Taxi.

NENI 10

Me qëllimin arritjen e objektivit të shoqërisë, ajo ka të drejtë të merret me gjithçka që ka lidhje me objektin e saj duke përfshirë të gjitha veprimet tregtare për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, financiare e bankare edhe me veprime të zbuluara (përfshirë mbledhjen e fitimit) duke pranuar pjesëmarrjen në fitim si dhe marrjen pjesë në shoqëri të tjera dhe sipërmarrjen me objekt veprimtarie analog të ngjashme ose të lidhur me të qoftë direkt, qoftë indirekt.

NENI 11

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e pajisjes me certifikatën e Identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT) nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.



NENI 12

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, në dispozicion të Shoqërisë mund të vihen fonde të tjera përfshirë dhe shtesa me anë të kapitalit në natyrë.

NENI 13

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë ose të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër tregtare si Brenda vendit dhe jashtë vendit, të zgjerojë objektin e veprimtarisë së saj, të ndahet në mirëkuptim mes ortakëve ose në rrugë gjyqësore, etj.

NENI 14

Organi më i lartë Drejtues Vendimor i Shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve e cila ushtron të gjitha kompetencat që i njeh **Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**

Ortakët mund të delegojnë kompetencat një ose më shumë Administratorëve të caktuar me vendim të Asamblesë së ortakëve, si dhe një person juridik jashtë shoqërisë, shtetas shqiptar ose i huaj mbi bazën e **Prokurës të bërë me akt notarial**.

NENI 15

Me vendim me shkrim Asamblesë së **Ortakëve** caktohet, shkarkohet **Administratori i Përgjithshëm** brenda ose jashtë bashkësisë së Ortakëve si dhe **Eksperti Kontabël i Autorizuar**.

NENI 16

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë, emërohet **Z. PËLLUMB ÇELA** atësia **Gëzim**, i datëlindjes 27.12.2003, dhe

Bazuar në **nenin 95 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**, **Administratori i Përgjithshëm Z. Pëllumb Çela** dhe emërohet për një **periudhë kohe 5 vjet**, me të drejtë ripërtëritje.



NENI 17

Detajimi në lidhje me problemet dhe administrimin e kapitalit themeltar dhe të pjesëve nominative të tij, Transferimi, Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit, mënyra e Drejtimit administrative të Shoqërisë, ajo e mbajtjes së llogarive dhe të Bilancit financiar, zgjerimi i Shoqërisë ose shndërrimi i saj në një formë tjetër Shoqërie Tregtare, bashkimi me Shoqëri të tjera tregtare vendsase apo të huaja, ndarja apo mënyrat e falimentimit të saj dhe kalimit në likuidim, etj., përcaktohen në mënyrë më të specifikuar në Statutin e Shoqërisë që i bashkëlidhet Akti Themeli.

NENI 18

Si rregull dhe përgjithësisht Ortaku drejton dhe zhvillon aktivitetin tregtar të Shoqërisë mbi bazën e mirëkuptimit profesional dhe ligjor.

NENI 19

Ky Akt Themelimi u redaktua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet, kuptohet dhe miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues të Shoqërisë Tregtare.

X -ALBANIA SH.P.K dhe nënshkruhet prej tij në të gjithë kopjet duke u vënë emri, mbiemri, dhe firma origjinale, autenticiteti i të cilave vërtetohet dhe nga Noteri.

ORTAKËT THEMELUES

TË SHOQËRISË TREGTARE ME ORTAKËRI X – ALBANIA SH.P.K

Miratues të këtij AKTI THEMELUES

z. Alman Kulla 